



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

I shkurtër nga procesverbali i mbledhjes së 25-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 21.12.2023, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Gentianë Hoxhaj, anëtare
14. Venhar Agushi, anëtar
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Lulzim Rustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Egzona Bytyqi, anëtare
21. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fadil Spahiu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragaçina, anëtare
28. Besiana Sylja, anëtare
29. Enver Kryeziu, anëtar
30. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Lulzim Rustemi, nënkryetar i komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Shkelzen Hajdini, DSH
7. Elmaze Behluli, DA
8. Sead Aliu, DI
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DA
11. Safete Amerrlahu, DGJK
12. Burim Rustemi, DSHPM SH
13. Imri Semetishti, DUPMM
14. Anila Reqica-LLugiqi
15. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha më lejoni që shkurtimisht të t'ju njoftoj që gjatë këtij viti kuvendi i komunës së Lipjanit ka miratuar gjithsej 58 akte, prej të cilëve 53 vendime dhe 5 rregullore.

Uroj që të vazhdojmë me punë edhe vitin e ardhshëm, duke u dëshiruar shëndet dhe punë të mbarë dhe suksese. Përveç saj, ju njoftoj që pas mbledhjes do ta kemi edhe një koktej rasti, të organizuar nga Kuvendi, që do të mbahet në restorant Centrum në katin e dytë. Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 24-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes në Magure
3. Propozim Vendim për miratimin e planit të punës të ekipit për të drejtat e fëmijëve (2024-2026) për Komunën e Lipjanit
4. Propozim Vendim për miratimin e planit të veprimit për transparencë i komunës së Lipjanit 2023-2027

5. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 15Nr.016/01-67386 i datës 22.12.2023 për miratimin e planit komunal për integritet 2023-2026 Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka veretje apo plotesime rreth rendit te dites.

Pastaj dhe se do te keni edhe nje pike shtese

6. Propozim Vendim Për miratimin e raportit mbi vlerësimin e dëmeve në bujqësi, ekonomi familjare dhe infrastrukturë publike të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në periudhën janar-nëntor 2023

Këtu bëhet fjalë për raportin që është bërë rreth këtyre dëmeve, ku më janë dërguar mua po është kërkuar që të votohet edhe në Kuvend, në mënyrë që qeveria të ribursoj këto dame që janë bërë.

Pastaj pyeti a ka verejtje rreth rendit te dites .

Arsim Jashari, tha se viti 2023 na ka percjell duke shti pika shtese Brenda senaces se kuevdnit ne ditën e fundit duke e neglizhuar edhe KPF-ne por edhe kuevndin, shpresoj qe vitin 2024 te mos na percjell me te nejtin gjendje.

Imri Ahmeti, kryetar i komunes tha se unë dakordohem në parim me atë që po e thotë Arsimi, unë besoj e keni një material, që na ka ardhë është me 18 të këtij muaji, se çfarë date jemi. Cila është arsyeja me u kthye një akt administrativ retroaktiv na vepru mbrapa, meqenëse në Kuvend tonë është aprovu më herët. Një vjet mbrapa na kthen një shkresë e ministrisë atje, në fakt e agjencisë, dhe kërkon që kjo punë të anulohet në Kuvend. Unë mendoj që duhet me i përmbajtë kësaj shkrese. Eshtë në një komision është për ekonomitë familjare, një komision për tokat bujqësore dhe një komision është për infrastrukturën publike.

Eshtë mirë me qit në rend të ditës, sepse munden me na penalizuar këta qytetarë.

Arsim Jashari, tha se pajtona ne parim me kryetarin por me te vërtet kjo është bere si praktike e keqe për kuvendit qe me ardhe pikat ditën e fundit pasi qe nuk po kemi mundesi qe me i përgatitë.

Pastaj Kryesuesi e hodhi ne votim rendin e ditë së propozuar dhe pas votimit u konstatua se me 25 vota per dhe 4 kunder u aprovua rendi ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Arsim Jashari, tha se fillimisht, më lejoni që në emër të Grupit të Asamblesë së PDK-së t'ju uroj festat e fund vitit, duke u dëshiruar të gjithë qytetarëve shëndet dhe lumturi në jetë. Si kuvend, kemi ruajtur frymën parlamentare respektuar mendimit e të tjerëve. Kërkesa e parë është për vendosjen e mbrojtësve të urave. Është mirë si ekzekutiv me gjete një zgjidhje dhe me i vendos mbrojtëset e urave. Kërkesa e dytë vjen prej qytetarëve të cilët ankohen se te rruga te shkolla fillore Vëllezërit Frashëri ku po i ndalin prindërit kerret midis rrugës, , është mirë me u bërë një nënkalimi, dhe mos bllokuar rruga, ka 2 orë,3 orë ,pasi qe aty bëhet kolonë çdo prind shkon me kerr me marrë fëmijën. Kërkesë e tretë ka ardhë, nuk e di një se ka dërguar Kryetari i Këshillit të fshatit të Gllgovcit, janë dy vite që po kërkojnë hapësirë për varrezën, nuk kanë vend për varreza, nuk e di a ka ardhë një kërkesë e këtyre banorëve. Çka po ndodh, me rregulloren për veprimtaritë ekonomike? Ne e dimë deri disa gabime që kanë qenë, janë eliminuar e kemi votuar të gjithë, pse nuk ka ardhë në Kuvend sivjet. Pyetje për drejtorin e Bujqësisë, në Kuvend i kemi nda 10 mije euro për trajtimin e qenve endacak Po më intereson me ditë çka është bërë deri sot në këtë aspekt. Pyetje për drejtoreshën e Kulturës së pse nuk po zhvillojnë garat kampionale në sallën e re në palestrën që është promovua? E kam edhe një pyetje, nëse është e vërtetë: a ka mundësi me qenë menaxherja në Shtëpinë e Komuniteteve nga vitit 2012 ushtruese detyre? Nëse nuk është e vërtetë, si ka mundësi me qenë ushtrues detyre që në njëmbëdhjetë vjet?

Egzona Bytyq, tha se diskutimin tim s'do e ngrisë në formë të pyetjeve, fillimisht për drejtorin e Inspektionit se sa po zbatohet Udhëzimi Administrativ i Ambalazhit dhe mbeturinave të ambalazhit, i cili ka për qëllim mbrojtjen e ambientit në përgjithësi dhe dua të di në përmbajtje dhe sa po respektohet tek ne. Pyetja dytë ose çështja e dytë për këtë drejtori domethënë dua të di, meqenëse jemi në prag të festave të fund vitit a i kanë shtuar inspektimet tek operatorët ekonomikë domethënë a po abuzohet me çmime, dua të di si qëndron puna, pasi qe edhe qytetarët kanë pasur ankesa lidhur me atë se sapo sa është çmimi real në raft edhe në arkë. E kam një propozim për Komunën për këto festa, dua të marr një vendim, në këtë rast që të dal në vendim për ndalimin e ndezjes së mjeteve piroteknike në hapësirat publike në përgjithësi, në hapësirat afër banimeve, thjesht kjo edhe për me e mbrojtë shëndetin e qytetarëve në përgjithësi, edhe për me e ruajtë cilësinë e ajrit. Gjithashtu, po i drejtohem edhe DKA-së, po e paraqes para jush atë nevojën elementare dhe esenciale që kanë Tualetet e shkollës fillore paralele e ndarë në fshatin Qylagë për renovim, pas kësaj seance do i nxjerrje edhe me foto edhe keni me pa të gjithë se për çka po flas domethënë thjesht ato tualetet ishin të demolume dhe të dëmtuame skajshmërisht. Çështja, kisha kërkuar që të trajtohet dhe të merret me seriozitet, është në shkollën

fillore në Magure, që ajo hapësirë, ajo shkollë ende, domethënë përkundër që unë e kam ngritë një herë, vazhdon të pastrohet me batanije, kërkoj që të gjeni mundësi financiare për modernizim të pajisjeve të pastrimit, sepse me të vërtet janë shumë të nevojshme. Për fund, ju falënderoj të gjithëve për vëmendjen, uroj që viti dy mijë e njëzet e katër të jetë vit i suksesshëm, të jetë vit i mbarë për të gjithë, uroj që të gjithë ju të gëzoni fillimisht shëndet të plotë dhe të jeni produktivë dhe të suksesshëm në punët tuaja të përditshme.

Lulzim Rrusemi, tha se kam disa pyetje dhe kërkesa, e para për Drejtorinë e Kulturës, Sportit të Rinisë desha me pyet për sallën e re, a ka Kondita Olimpikë Salla, meqenëse e kemi lojën mesdhetare tash në Kosovë, kisha pasë dëshirë që edhe Lipjani të jetë në lojën mesdhetare dhe në disiplina që mbahen edhe në Lipjan dhe kish me qenë një krenari e veçantë për Lipjanin, por edhe dobishme për qytetarët në komunën e Lipjanit. E dyta, për Drejtorinë e Arsimit ka një ankesë të shumë shkollave, se nxehjet nëpër shkolla nuk funksionojnë siç duhet dhe temperatura optimale nëpër lokalet të brendshme të shkollave nuk është në nivelin. E treta, kam edhe një pyetje për nxehjen në Bibliotekën e Qytetit ka pasë ankesa se biblioteka e qytetit nuk do të funksionojë. Në fund po e falënderoj Kuvendin dhe ekzekutivin për një bashkëpunim gjatë vitit që kalon, për një bashkëpunim sukses shumë të mirë, uroj që vitin 2024 niveli i angazhimit të Kuvendit të shkojë në nivel tjetër, të rritet niveli i angazhimit, të jemi më produktivë dhe të jemi në shërbim të qytetarëve dhe sukseset të mos na mungojnë.

Ganimete Qeriqi, tha se është e rendit sot para jush me u lavdëruar asfaltimi i Grykës së Shpëtimit në Krojmir. Por kjo nuk duhet përfunduar me kaq. Duhet një hapje, promovim zyrtar, një dokumentar që i kushtojë asaj rëndësie historike. Konkretisht po e kërkoja që edhe në vendin ku është varrosur për here te pare martirja e fshatit Krojmir Aferdita Shaqë Qeriqi, ta ketë një pllakë përkujtimor, edhe Musli Bungu... Tani ka fillua ndërtimi i objektit të ri QKMF dhe urgjencës, në Lipjan a keni lan një vend në objekt ta ketë një byfe ku duhet të ushqehen punëtorët. Tjetra Akllapi, Janjeva kanë probleme me udhëtim, janë të privuar nga puna, shkollimi trajnimi ete tjera shkaku se ju mungon udhëtimi. Shume gra dhe vajza kanë interesim me punuar por kanë sfida udhëtimin, se furgonat lëvizin rrallë. Është mirë me u ndihmuar furgonat me shtuar linjat brenda ditës. Salla e kuvendit s,po ngrohet salla është lart nëse doni zgjidhje nxemsja duhet me qen ne pod.

Besiana Sylja, tha se edhe unë si kolegu Arsimi, dashta me ngritë ose me tërheqë vërejtjen që ka të bëjë me fshatin Banullë për rrethojat mbrojtëse në urëkalime. Kërkoj

nga Komuna e Lipjanit të vendosen mbrojtëse rreth urave të këtij fshati, për arsye se për shkak që jemi në sezonin e dimrit kemi edhe ngrica kemi pranuar disa ankesa nga disa qytetarë të këtij fshati, që po rrezikohet shumë jeta e fëmijëve të cilët vijnë edhe mësimin dhe kalojnë kohë pas kohe nëpër këto ura. Një tjetër çështje ka të bëjë me ndriçimin në fshatin Krojmir, nga atje kam pranuar mesazhe që ndriçimi në rrugën 22 maji ka probleme për shkak të ndezjes së llambave ndriçuese me një shpejtësi, e cila po shkakton pengesa, është mire që komuna të angazhojë ndonjë kompani që të shkojë për t'i kontrolluar dhe rregulluar ato. Pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, me datë 27 nëntor ishte në plan me u shfaq një film i titulluar Luaneshat e Kodrës. Ky film iu është dedikuar grave ndaj të cilave është ushtruar dhunë dhe i cili me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë është kërkuar lirimi i kinematografisë, e cila gjendet në shtëpinë e kulturës dhe kjo kërkesë është anuluar, kërkoj nga drejtoresha të na jep një sqarim për anulimin e kësaj shfaqjeje apo në prapavijë edhe ka ndonjë arsye politike pse nuk u shfaq ky film.

Rinor Murati, tha se me që është seanca e fundit për këtë vit e Kuvendit Komunal uroj secilit shëndet, sukses dhe mbarësi. Tashmë Kosova ka fituar të drejtën e organizimit të një ndër ngjarjeve më të mëdha sportive që organizohen dhe padyshim ngjarjen më të madhe sportive në vend, lojërat mesdhetare, Prishtina 2030 Rreth kësaj, ministri për kulturë, rini dhe sport ka prezantuar konceptin fillestar të organizimit të kësaj ngjarjeje, ku përfshinë 11 komuna, por që përjashton Lipjani. Bazuar në këto, pse komuna e Lipjanit është lënë anash nga këtë projekt i prezantuar, a ka pasur takime prapë rreth kësaj çështjeje apo ka ndonjë njoftim rreth kësaj?

Shahadije Dragaçina, tha se pyetja ime e parë ka të bëjë me marrëveshjen që komuna e Lipjanit e ka arritur me Komunën e Prishtinës, që ku përfshihet edhe transporti. Më interesohem të di se çka përfshihet marrëveshja ma konkretisht kur pritet të lansohet linja Janjevë-Prishtinë. Çështja e dytë ka të bëjë me Shkollën e Janjevës, ku kam marrë ankesa nga prindërit për shkak se ska nxemje të mjaftueshme për shkak të dritareve të vjetër që janë atje. Komuna e Lipjanit ka planifikuar në ndërkohë që të bëhet renovimi e eficient edhe në Shkollën e Janjevës, por një gjë e tillë është bartë për vitet tjera. Një çështje tjetër, ka të bëjë me mjetet piroteknike, pra që është shqetësuese po shohim që ka ndezje të mjetet piroteknike vend e pавend, vitin e kaluar komuna e ka marrë një vendim ku i ka ndalu sidomos në sheshe që mos të përdoren ato mjete a ka diçka konkrete ndonjë vendim, a do ta marrë komuna lidhur me këtë çështje.

Ardit Cani, tha se sot do të ngris disa çështje dhe kërkesa. Së pari do të ngrisë çështjen e asfaltimeve në rrugicat në fshatin Bainsë. Unë e kam cekur disa herë më

herët, gjatë seancës të vitit të kaluar. Si kryesie e fshatit rëndësi dhe prioritet në fshatin Baincë ju kemi dhënë të rrugicave, ku kemi në rast invalidë dore. Rrugët kanë filluar të asfaltuara mirëpo tek këto rrugica ende nuk kanë filluar punimet dhe besoj që edhe kryetari ka cekë edhe në seancat e mëhershme që prioritet do të jenë këto asfaltime të rrugica, pasi që janë një pjesë të më ndjeshme të shoqërisë tonë, për t'i mundësuar edhe lëvizja e tyre. Rrugët janë të kontraktuara, mirëpo kërkoj që t'i jepet prioritet këtyre rrugëve, çdo asfaltim është e mirë sa orë, por prioritet të jenë këta. Kërkesë tjetër është nga banorët e fshatit Resinevc dhe Kryesia e Fshatit Resinevc, të cilat e kanë një kërkesë drejtuar Drejtorisë së Arsimit për rrënimin e shkollës së vjetër në Resinevc, e cila po i rrezikon nxënësit e këtij fshati dhe kërkojnë që në mënyrë urgjente të merret me kete çështje. Një kërkesë tjetër e kam në kuadër të Komitetit për Kulturën, Rinisë dhe Sport, bashku me Drejtorinë e Kulturës dhe Rinisë dhe Sportit kemi mbajtur takim me përfaqësues të sporteve në Komunën e Lipjanit. Gjatë këtij takimi kemi pasur kërkesa të ndryshme nga ta, nga përfaqësuesit e sportit, ankesat e tyre kanë qenë për mos mbështetje të duhur të klubeve. Ka qenë një kërkesë e cila më të vërtetë ishte më serioze nga klubi i atletikës, të cilët kërkuan që të bëjnë ndërtimin e shtegut 400 metra, pasi që me të vërtetë janë duke bërë një sukses dhe janë një krenari e klubeve në Lipjan.

Fadil Spahiu, tha se unë kam dy kërkesa për ekzekutivin, kërkesa e parë është bërë nga nxënësit e shkollës së mesme të lartë të fshatit Smallushë dhe Glllogovc. Nxënësit e shkollës së mesme të lartë të fshatit Smallushë dhe Glllogoc kanë ngritur një shqetësim lidhur me pagesat e udhëtimit me transportit të rregullt urban periferik, të cilët udhëtojnë në relacionin e linjës Smallushë-Glllogoc-Lipjan. Shqetësimi i tyre është se nga kompania përgjegjëse e relacionit të kësaj linje nuk lejon të bëhen pagesat në baza mujore, por vetëm në baza ditore, edhe pse nxënësit udhëtojnë rregullisht. Kjo ndalesë ka filluar të aplikohet rreth dy apo tre muaj më parë, e që nxënëse po i shkakton mund dhe kosto më të lartë të pagesave. Kërkesa e dytë është banorët e fshatit Smallushë që të bëhen sinjalizimi horizontal me vija të bardha, të plota dhe të ndërprera në rrugën e një qershorin e fshatit Smallushë për arsye të përmirësimit të kushteve dhe ngritjes së nivelit të sigurisë që pjesë me arsye në këtë rrugë.

Lumturije Bytqi-Hasani, tha se çështja e parë që dua të ngrisë është, në fshatin Akllap tashmë ka filluar implementimi i projektit të shtirjes së kanalizimit, mirëpo nga bisedat që qytetarët atje kanë pasur përfshirje në gjithë fshatin. Kjo fjala është për rrugën Ibrahim Gashi, ku jetojnë disa banorë, mirëpo ata nuk do ta gëzojnë shtrirjen e kanalizimit, pra si një nevojë mjaft e madhe për çdo familje. Pyetja është pse duhet me u përjashtua disa familje në fshat, ndoshta edhe kontraktori nuk ia ka dhënë përgjigje

të sakte. Pyetja e dytë është për rrugën që lidhet me rrugën “Tahir Sinani që shkon përreth emergjencës dhe del te rruga e Lagjes Doktorëve, aty mungon trotuari dhe ndriçimi. Çështja tjetër është që e përmendi edhe Dija e Ganja, e kam lexuar njoftimin që komuna, kryetari i komunës ka bërë marrëveshje me komunat e regjionit të Prishtinës në linjës së transportit urban. Shumë shpesh në këtu e kemi përmendë ngritjen e çmimeve që po ndodh, fatkeqësisht edhe në biletat e autobusit. A do të ketë ndonjë çmim më të volitshëm, po pasi për nxënësit dhe studentët të cilët kanë destinacion Prishtinën nga kjo linjë që tashmë e keni një lidh marrëveshje?

Alban Salihu, tha se edhe unë ju uroj vitin e ri, të gjithë qytetarëve fillimisht ju dëshiroj shëndet e edhe suksesin e veprimtaritë e tyre, krejt atyre që merren me punë publike dhe që për qëllim kanë ë të mirën e përgjithshme dhe mirëqenien e qytetarëve ju dëshiroj punë të mbarë. Çështja e parë që dua të flas shkurt, ka të bëjë me një vizitë timen që e kam bërë dje në fshatin Bujari, ku kam vizituar me kërkesë të disa banorëve lagjen Selimi dhe kam parë që gjendja infrastrukturore e disa shtëpive aty, është tejet e vështirë, problemet e tyre ishin edhe në rrugën edhe me trajtimin e ujërave të zeza. E ftoj drejtorin e drejtorisë përkatëse që ta bëjë një vizitë te kjo lagje dhe të gjejë hapësirë buxhetore që të fillojë me investime, për shkak që nuk kishte mundësi që të pritët edhe më, për shkak që situata ishte goxha kaotike. Çështja e dytë ka të bëjë me sigurinë e qytetarëve, a ka menduar ekzekutivi i Komunës të Lipjanit, përkatësisht drejtoria e inspektoratit, që të fillojë të vizitojë ndërtesat për t'i inspektuar ashensorët në këto ndërtesa. E ftoj ekzekutivin e Komunës të Lipjanit që të fillojë që të shohë se sa ashensorët janë të sigurt në ndërtesat.

Nexhmedin Lekiqi, tha se unë kam dy çështje, një e kam propozim edhe pak kritik. unë një ditë kam dal me veturë rreth Lipjanit dhe kam parë që ka qytetarë të shumtë që ecin në këmbë, dhe presin autobusin, mirëpo nuk ka bus stacione te mjaftueshme për këta qytetarë dhe në ditët në shi tash edhe në borë nuk është lehtë me i pa nënat në të fëmijët të vegjël tu pritë në stacione. Unë kisha propozua që të merret një iniciativë të ndërtohet këto stacione e te ju bëjmë një zgjidhje këtyre udhëtarëve që udhëtojnë në këmbë. Të dytën, desha me falënderua posaçërisht Drejtorinë e Shëndetësisë, ku na si komitet kemi bërë një ku i kemi cekë edhe të mirat edhe të metat. Për atyre të metave apo gjërave që i kemi propozua, komision tyre janë plotësua. Janë marrë parasysh shumica e rekomandimeve tona dhe gjendja që kanë ardhë në vend një prej tyre është edhe QMF-ja në Gadime.

Fitim Mëziu, tha se është vërtet një lajm i gëzueshëm në komunën e Lipjanit që tanimë po ndërtohet një objekt i mirë i qendrës kryesore të mjekësisë familjare së bashku edhe me emergjencën. Mirëpo, po merr parasysh që politikat shëndetësore të

Organizatës Botërore të Shëndetësisë kanë theksuar që duhet edhe në vendin tonë të ketë një qasje tjetër pasi ka ndryshuar sistemi, pra një qasje drejt mjekësisë familjare, mendojmë pasi në këtë legjislaturë kemi më së shumti profesionistë shëndetësorë që ne të gjithë së bashku duhet të japim një kontribut në organizimin e punës në kuadër të kujdesit primar shëndetësor. Arsyeja pse dola është sepse ndoshta keni pa në muajt e fundit kur ka qenë një konkurs për specialistë të lëmive të ndryshëm, e një prej tyre për mjekësinë familjare ne duhet me i ditë çka do të ndodhë pas dhjetë vjetëve, sepse mjekët tanë do të pensionohen, do të mbetemi pa mjekësi familjare dhe ajo është që është më e rëndësishme, ne duhet t'i japim një motiv këtyre mjekëve të ri që të zgjedhim mjekësinë familjare si një prej hallkave kyçe të çdo komune dhe në këtë rast e kam fjalën për komunën e Lipjanit. Pse ka ndodhë deri te ky de motivim, jo vetëm te ne në Lipjan, por edhe në komunat tjera, është mendoj pikërisht pikërisht keq menaxhimi domethënë jo motivimi i profesionistëve të ri për me ardhë dhe me zgjedhë mjekësinë familjare, duke mos e zgjedhur këtë vend vetëm si ambient i kritikave, por prapë po t'i theksoj, jemi një numër i madh i profesionistëve shëndetësorë në këtë legjislaturë, t'i japim një kontribut, jemi në mes të mandatit, kemi edhe dy vjet, të rikthejmë në pozitivitet jo vetëm për profesionistët shëndetësorë, por edhe për qytetarët tanë që do të marrin shërbime shëndetësore cilësore në kujdesin primar shëndetësor.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës së Lipjanit, tha se po ju përgjigjem disa pyetjeve e para për qasjen në shëndetësi po nisem prej fundit, është çështje gjithëpërfshirëse e gjithë vendit tonë, jo vetëm e Lipjanit, dhe është një problematikë që na përcjell, ne që njerëzit e kësaj fushe duhet me marrë ma shumë. Ishte një pyetje për bus stacionet që u tha, se pari rrugët regjionale, Janjevë-Lipjan rruga prej QMI-së që shkon Prishtinë, siç është rruga prej Llugaxhisë që shkon për Gjilan, dhe siç është rruga prej Magubës që shkon deri në Kleçkë janë rrugë regjionale kur të kërkon me investuar duhet me ditë që ne nuk e kemi një kompetencë dhe neve na duhet me merr pëlqime e leje të caktuar nga ministria, sepse kështu është e rregulluar me ligj. Dakordohem plotësisht për bus stacione ekzistojnë. Tani rrugicat në fshatra të caktuar, shumica e kontraktume problemet me kompani janë jashtëzakonisht të theksime, shumica prej këtyre kontratave janë kah përfundimi ose do të shkëputen në këtë vit, do të penalizojnë ato kompanitë që s'ju kanë përmbajtur kontratës. Një pjesë e kontratave janë dy vjeçare që vazhdohet edhe vitin e ardhshëm. Transporti për Janjeven, ne e kemi lidhë një marrëveshje me Komunën e Prishtinës, është një kërkesë e jona, goxha moti e zhvillime dhe ma në fund kemi arritë marrëveshjen, tash do të ndërtohet edhe një agjendë e zbatimit të këtyre marrëveshjeve në komunat e regjionit dhe unë po besoj që gjatë vitit të ardhshëm nuk mund ta them saktë se në muaj për

Janjevë do të ketë një transport që do të vazhdojë Lipjan dhe Prishtinë. Cili është çmimi është pyetje që nuk e di, sepse komunat dhe as shteti nuk mund të ndërhyjnë çmime, Pjesë e kanalizimit në Akllap, po përfundon si kanalizim ne e kemi vijat kah ka kanalizim dhe vijat që s'kanë kanalizim dhe do të ndodhë shtrirja e rrjetit të kanalizimit edhe në Akllap në pjesë që s'kanë pasë. Pat edhe kërkesa për transport publik prapë për vija ose për shenja të trafikut horizontale vertikale. Natyrisht që rrugë kryesore e kanë, rrugë sekondare nuk kanë. Sivjet rrugë primare janë pasie me sinjalizimin. Pse është përjashtua Lipjani ose pse nuk është në tabelën e komunave për lojërat olimpike , nuk e di pse. Palestra është funksionale, por kemi problem me trafo, unë me herët pata takim me KEDS-in sepse atje duhet mu vendosë një trafo e re. KEDS-i për të ndërhyrë në këtë pjesë të lokalitetit të afërt të palestrës sportive, do të vendoset një trafo e re. Përndryshe palestra është e gatshme tash me u shfrytëzua. Pat ë idetë që biblioteka është ftohtë, shkollat janë ftohtë, mund të ketë, edhe shkolla një ditë eventualisht dy ditë prishje, të cilat i rregullohet shpejt. Mund të ketë një ditë dy ditë, mirëpo nxemje ka gjithkund. Te qentë endacak, mendoj që drejtor Rexhë mund të na e japë një informatë më të saktë, për aq sa e di ju është trajtuar një numër i madh në qendrën endacak. Hapësirë për varrezë e Gllgovcit nuk e di, nuk më kujtohet që nuk ka ndonjë shkresë. Rregullorja për punës është në proces, ne s'kemi marrë vendim me anulua thjesht kam shikuar mundësinë e harmonizimit edhe me komunat tjera, sepse një pjesë e madhe e komunave nuk e kanë. Problemi është natyrisht që duhet me e matë sa reflekton me komunat fqinje, sepse na mbyll midis Lipjanit e tek komunë tjetër, qel nuk është fort e lehtë edhe për ne. Pat kërkesa edhe për shteg të atletikës edhe për çështje tjera, mendoj që nuk i kemi as kapacitetit buxhetor për të gjitha. Pat kërkesa për mbrojtje të urave unë kam kërkuar të bëhet një projekt i përbashkët për parkingje para çdo shtëpie të komunitetit ose shtëpie për të pame që po bëjmë në gjithë komunën tonë, para çdo xhamie ose objekti tjetër fetar, para çdo shkolle ose institucioni tjetër shëndetësor në gjithë territorin e komunës dhe me një projekt i përbashkët do të bëjmë parkingje për të gjitha këto shtëpi edhe do të rezervohen natyrisht edhe për persona me aftësi të kufizuara dhe çështjen e ndërtimit të ujërave aty këtu ku janë të nevojshme për qarkullim.

Alban Salihu, tha se për shkak të fundit të vitit unë e pashë një vullnet të mirë të asamblistëve që sot me kaluar kështu në një atmosferë më festive, por kjo është e pamundur për shkak që na e kemi një Kryetar, është nguca keq domethënë e merr kompetencën t'i vlerësojë pyetjet nëse janë të mira apo nëse janë të këqija. Por nuk ka pyetje të këqija ,mundet me thënë se është mungesë përgjigjesh, mungesë të punëve.

Shkelzen Hjadini, tha se një pyetje ishte rreth fuqizimit të konceptit të vizitave në shtëpi, ne kemi rritë ekipin kemi i kemi operuar edhe me një veturë, tash ekipi i veturën në dispozicion. Përveç pallativit, që është fuqizuar edhe me staf edhe me logjistikë, është fuqizuar edhe vizitat në shtëpi me një veturë edhe këshillimorja dhe me një infermier shitesë. Tash i kemi tre infermierë, në këshillimore do t'i kemi edhe një infermier tjetër. Raportin e Komitetit për Shëndetësi e kena marrë me seriozitet, shumica e rekomandimeve janë plotësua, është bërë një progres, një avancim i mëtutjeshëm. Mjekësia familjare duhet një qasje ndryshe, një qasje edhe në nivelin komunal edhe në nivelin qendror, ngase motivi nuk është i mjaftueshëm. E kemi informacionin që tridhjetë e katër kërkesa kanë qenë vetëm për mjekësinë familjare, e kjo prek sidomos pushtetin lokal, prek sidomos komunat, ngase kujdesi primar është mjekësia familje. Ne jemi si një ndër katër komunat pilot-projekt për zoonimit, e këtu mund të jetë edhe disa iniciativa për mjekët familjarë. Ne do të jemi bashkë dhe ne do të angazhohemi bashkë me e shty procesin përpara.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 24-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 23 e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 25 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 24-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes në Magure

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit drejtor i DKA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Xhuzide Rrustemi, tha se ne si grup parlamentar i LDK-së e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës. Kam disa fjalë si kryesuese e Komitetit për Arsim, pas gjitha vizitave që kemi pasur në çerdhe të ndërtuara më herët, siç janë çerdhja në Sllovi, Gadime, Shalë e ajo që pritet të përurohet në Rufc. Duke parë se pas fazës testuese çerdhet e caktuara më lartë kanë pasur një performancë të mirë, e shohim me nevojë që të shohim edhe disa çerdhe në lokalitete tjera të ndërtuara si këto çerdhe të bukura. Ajo që kërkoj nga ju të pranishëm është që të votohet ky lokacion, e të shtyhet para për të futur në buxhetin e nivelit qendror.

Egzona Bytyqi, tha se na para veti të kemi një propozim-vendim tejet të rëndësishëm si hap i parë për ndërtimin e çerdhes në Magure. Në mandatin e parë ka qenë njëra ndër kërkesat tona bazike, po mendoj asaj rrethine për ndërtimin e kësaj çerdhe, ajo çka kisha pasur dëshirë të mos ndodhë domethënë është që mos të kemi probleme me mësimdhënës. Përndryshe, në mënyrë unanime, ne si grup parlamentar këtë propozim-vendim e votojmë dhe jemi pro.

Fadil Spahiu, tha se meqë qëllimi i ndërtimit të çerdhes në Magure është përparimi e kushteve për edukim të grup moshave të hershme që do të shërbejë për interes të përgjithshëm për të gjithë banorët e të gjitha fshatit Magure e mbështetës këtë prezent vendim. Po ashtu është e nevojshme që edhe në lokacionet e tjera si në Magure të ndërtohen çerdhe, sepse kjo do të ndihmonte prindërit që të kenë mundësi të punësohen.

Arsim Jashari, tha se në mbështetje me atë çka tha doktoresha, po e kam një pyetje për drejtorin edhe për kryetarin e komisionit, sa është parimore çerdhja e fëmijëve me qenë afër shkollës? Unë e di që e ka edhe anën pozitive, por ka edhe ana negative. Ana pozitive në kamerat janë në qoftë se aty janë nxënës tash brenda, por ana negative ata fëmijë deri në tre vjet kanë me shkuar me fjetë. Fëmijët e shkollës fillore bëjnë zhurmë, bëjnë probleme, kanë me lënë me kreativ Po më intereson me ditë se sa është i parimore, domethënë me i mbështetë këto gjëra, se pa çerdhe nuk bën. Nëse dojna me avancuar gruan por sa është parimore brenda objektit, të shkollës.

Gentianë Hoxhaj, tha se unë kam një pyetje për drejtoreshën çka nëse ministria nuk e ndërton këtë çerdhe në Magure?

Armend Grajqevci, tha se një replikë veç e kisha bo një replikë për Arsimin, pasi që jam edhe pjesë e Komitetit për Arsim dhe i kemi vizituar të gjitha çerdhet e komunës së Lipjanit. Çerdhet janë vendosur brenda oborrit të shkollës, veç po dua me potencuar që kërkesat që i kemi marrë prej stafit të çerdhes nuk kanë pasë zhurma

prej fëmijëve të shkollave fillore ose diçka tjetër. E vetmja kërkesë që e kanë pasë është mungesë të mjeteve didaktike dhe po besoj që shumë shpejt kemi me realizua edhe këtë kërkesë.

Arsim Jashari, tha se, nuk ma kuptoj pyetjen atë që e thashë unë, kolega i nderuar, unë nuk thashë që ka pasë ankesa. Unë thashë sa është parimore, në parim. Ndoshta me pyet drejtorin, se është informuar në mandatin e dytë që e udhëheq dikasterin.

Armend Grajqevci, tha se nuk me ka kuptuar as mua përderisa nuk ka pasë kërkesa dhe ankesa, është parimun për me ndërtuar atë.

Arsim Jashari, tha se ky është mendim i yt, por unë pyeta në aspekt parimor jo në aspekt të veçantë. Përndryshe ne si grup e mbështesim.

Rasim Hasani, tha se zakonisht çerdhet ndahen prej shkollave dhe kur është brena oborrit, domethënë brenda asaj njësie kadastrale, ndahen me hyrje të veçanta edhe nuk ka diçka që është me parë problemi shtesë. Përveç nëse ka zhurmë më tepër të mëdha, në rast se që na nuk e lejojmë, për shkak se çdo punë e kemi nda në gabime e kemi nda me rrethoja dhe nuk kanë qasje nxënësit e shkollës së fillore. Genta e bënë një pyetje, masi veç dola: është interesant se çdo sqarim që jepet del ministria tani me reagime politike. Në buxhet që këtij viti përkundër kërkesave, te shumta nuk ka ansjë projekt.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për miratimin e planit të punës të ekipit për të drejtat e fëmijëve (2024-2026) për Komunën e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHPS në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ky plan është mjaft mirë i detajuar, i cili përmbledh të gjitha të drejtat e fëmijëve të garantuara me legjislacionin në fuqi të Republikës tonë, Kushtetutës dhe konventave ndërkombëtare, që shteti ynë tashmë është falë asaj. Me Komitetin Komunitete kemi qenë në një vizitë në shkollën në Gadime disa fëmijë kanë kanë braktisë shkollën, janë nga Komiteti RAE dhe do të

doja që gjatë zbatimit të këtij plani të fokusohet braktisja e fëmijëve nga komitetet jo shumicë në komunën e Lipjanit Çështja tjetër është që dua të ngris se sa do të merremi me fëmijët me fëmijë të cilët abuzohen dhe përdoren nga prindërit dhe ndoshta edhe nga organizata të ndryshme për kërkim lëmoshë Fatkeqësisht, edhe në Lipjan shohim shumë fëmijë të cilët kërkojnë lëmoshë. Prandaj, do doja shumë që jo si institucion që të fokusohemi në këto dy kategori, të cilat, fatkeqësisht, shohin shkelje të rëndë të drejtave të fëmijë. Një plan mjaft i mirë, uroj që të zbatohet në përputhshmëri.

Fitim Shala, tha se e falënderim drejtorin për shpalosjen e këtij plani me rëndësi të veçantë për fëmijët, të cilët janë e ardhmja e komunës, si dhe njëkohësisht e shtetit tonë. Në bazë të objektivave dhe strategjive që përmendi drejtori na tregon që kërkohet të fuqizohet një bashkëpunim i përhershëm me qytetarët, prindërit, arsimtarët, profesionistët shëndetësorë, shërbimet sociale si dhe shërbimet kulturore dhe sportive. Ne si grup e mbështesim këtë plan, i cili domethënë është shumë i rëndësishëm.

Lulzim Rrustemi, tha se unë nuk po du në detale me hi, por mendoj që është i konceptuar mirë, është i ndërthurur mirë, por ka edhe disa vërejtje elementare, meqenëse është program zyrtar, është një plan që ka një përbërje të mirë, ka një shumësi të elementeve që janë nxjerrë, por meqenëse është dokument zyrtar ky plan ka edhe disa të meta që unë i kam pa që janë të meta teknike e të cilat duhet të përmisrohen . E para, numri i popullsisë është gabim, domethënë duhet të bëhet një plan i mirë, pasi që qytetarët i lexojnë. Te shëndetësia keni për shembull, AMF-të në Smallushë dhe Banullë, nuk funksionojnë, nuk ka nevojë ndoshta edhe me figuruar fare në dokument. Te arsimi ka vërejtje të jashtëzakonshme të numri i nxënësve, janë gabime teknike, të cilat do duhej me i përmirësuar, janë gabime elementare. Te plani i veprimit, që është një nga shtyllat kryesore, sepse plani i veprimit e mbërthen krejt strategjinë që është dhe ai duhet të përcillet , unë kisha pasë shumë dëshirë shëndetësia, sidomos vizitat e shkollave, vizitat e institucioneve shkollore në planin operacional me u detalizuar, fëmija janë pasuria më e madhe kombëtare e një shteti. Prandaj, për fëmijët e shëndetshme duhet një kujdesi jashtëzakonshëm. Unë kisha propozua në secilën shkollë që veç secila klasa të monitorohen, të bëhen edhe kartelat për secilin nxënës dhe të kontrollohet deri në moshën e rritjes, sepse kur e ka kartelën, i ka defektet, është shumë e rëndësishme që në moshën e hershme mu identifikuar defektet. Unë e di që ka kontrolle në shkolla, më shumë bëhen rutine, bëhen shumë të rralla, bëhen sa për të kapërcyer për to, por është e rëndësishme me i bë në vizita në shkollë, me i kështu ata në tani në kontrolle të rregullta. Përndryshe ne e përkrahim këtë plan.

Fadil Spahiu, tha se duke bazuar në draft-planin e punës së ekipit për hartimin e planit të punës për të drejtat e fëmijëve 2024-2026 për komunën e Lipjanit, e mbështes këtë propozim-vendim për miratimin e këtij plani.

Shkelzen Hjadini, tha se po ky plan adresant një ndër objektivat dhe shumë aktivitete janë të detajuara rreth sigurimit të një arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjitha komunitetet dhe të gjitha kategoritë. Sa plani do të a do të merret me çështjen e abuzimit të fëmijëve për kërkim lëmshë. I treti është mbrojtja nga dhuna dhe keqtrajtimi dhe këtu adresohet brena planit rreth planit t'ju informojë që planin e kem trajtua me kujdes, mund të ketë ndonjë ndonjë gabim teknik ose gabim gjatë futjes së të dhënave. Por ne do ti përmirësojmë para se te dërgojmë ne ministri.

Lulzim Rrustemi, është mirë që ne plane kur te punohet me dite edhe emrat e ekipeve të cilat kanë punuar.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit që të përmirësohen dhe korrigjohen gabimet teknike dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 25 vota për aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim për miratimin e planit të veprimit për transparencë i komunës së Lipjanit 2023-2027

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-LLugiqi nga DKRS-ja, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se fjala transparenca është fjala e madhe edhe kur të bëhet plani për transparencën duhet me parapa disa gjana çka ka bërë ekzekutivi për me qenë transparenca në nivel. Nuk mund me pasë transparenca si pas ligjit si qeverisjet lokale nëse qytetarët nuk janë aktivë dhe nuk janë pjesëmarrës. Cila është rëndësia e qytetarëve me qenë pjesë e tabelave të politikave të ekzekutivit. Unë i kam nxjerrë dhe për arsye se kur duhet dalë me kundërshtua diçka kam që me argumentu Cilat janë përfitimet e pjesëmarrjes ,Pra, ndihmon në marrjen e vendimeve, të cilat janë më pak të kushtueshme dhe të lehta për t'u zbatuar, përmirëson cilësinë e vendimeve, ndihmon në sqarimin objektiv të kërkesave të një projekti ose politike, ndërton konsensus, i cili shumë herë na ka mungua po flas për qytetarët. Çdo dëgjim publik duhet me ardhë zyrtarët e Komunës për me plotësua dëgjimin publik, dëgjimin publik

për menaxhimin e mbeturinave, vetëm unë kam qenë prej Komunës edhe zyrtarët e Komunës. Ne si grup, keni vendosë duhet me kundërshtuar këtë plan.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se obligim ligjor është vetëm incizimi i seancave me dërgua në ministri kaq. Transmetimi live, qoftë me zërin , qoftë me kamera është bërë për vullnetit tonë të mirë që me rri transparencën Nuk është obligim ligjor me shkua transmetimi live. Mirëpo ligjërisht e kem veç audio ingjizimi me dërgua në Ministri, me përcjellë Ministria e Pushteti Lokal.

Arsim Jashari, tha se mbledhjen e kaluar pata fjalën për zërmë, jo për video, nëse unë në Kuvend, mirë e lidhet ajo, por në Kuvendin e kaluar ka pasë shumë pengesa shikojë ka ndërpre në fjalime me nga 30 e 40 minuta. Edhe nuk ka ndodhë një herë, por ka ndodhë disa herë, sepse unë e di me e lexoj mirë e përgatitini e di që me video nuk është obligative por është zerimi obligative

Daut Azemi, na jena mundu vazhdimisht me dal sa ma mire po nganjëherë kemi edhe ne probleme.

Rinor Murati, tha se sa i përket kësaj pike e planit të veprimit për transparencë të komunës së Lipjanit 2023-2027, komuna e Lipjanit vec se e ka dëshmuar duke u ranguar ndër komunat e para në raportet e transparencës të cilat publikohen çdo vit. Edhe ky plan konsideroj se ka nevojë për përmirësime, gjë për të cilën do të angazhohemi bashkërisht në mënyrë që t'i evitojmë ato mangësi. Në emër të grupit e mbështesim.

Shahadije Dragaçina, tha se këtë plan kanë disa, llogaridhënia dhe transparenca janë parime informimit që synojnë mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në procesin e politikë bërjes dhe vendimmarrjes komunale un mendoj se këtu komuna ka dështuar për arsye se në Lipjan nuk ka qytetari aktive. Te plani i veprimit te aktivitetet transparenca e kuvendeve të komunës, ne jemi dëshmitarë të faktit se mbledhja e kuvendit transmetohet keq edhe zëri shkon keq ose edhe shpesh bëhet pa video, pra pa fotografi. Tjetra, publikimi i buxhetit vjetor pas miratimit në Kuvend, për shembull, nëse e merr e shikon buxhet nuk dihet cilat projekte te do kryhen ndërsa , në të e shikon buxhetin e Komunës së Shtimes, aty cekën lagjet që ndërtohen, rrugët që ndërtohen, cekën me emra, ndërsa kjo nuk ndodh, me komunën tonë. Tjetra, kur jemi te transparenca ne jemi dëshmitarë edhe të faktit se Kryetari nuk e merr asnjë mendim prej qytetarëve por vendos çka do vet. Po ashtu është cekur ofrimi i shërbimeve për qytetarët përmes e-kioska, unë qysh e di, ajo e-kioska është moti jashtë funksionit.

Pra, mendoj që ky plan mund t'ia përfshijë format e duhura për t'i aktivizuar edhe qytetaret.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se çështje e vullnetit tëm për me pas një transparencë më efikase, më të mirë në shërbim të gjithë neve, të gjithë qytetarëve ë një çështje tjetër që po dua me ë me shti. Shtimja ka vetëm dy rrugë si Gadimja Vlerësimi i komunës tonë ka qenë vazhdimisht ndër komunat e para më transparente në nivel të vendit dhe këtë e kanë bo organizatat edhe ndërkombëtare edhe vendore, vazhdimisht janë top,

Anila Reqica-LLugiqi-,tha se sa i përket mungesës së qytetarisë aktive, po besoj që është shqetësim i përbashkët për secilin nga ju, qe përfaqëson një grup të caktuar të shoqërisë, andaj de motivimi i shoqërisë për mospjesëmarrje në takimet që i fton komuna për me dhënë kontributin e tyre, po besoj që nuk është i nevojshëm secili nga ju mundeni me e ftuar shoqërinë ose lokalitetet që ju i përfaqësoni që të jenë pjesë aktive të debateve që na i ftojnë Ne nuk jemi të kënaqur, por secili nga ne mundet me dhënë kontributin e tij ,e jo për ironi, por është fakt ajo që e tha kryesues, ne ndër vite po shpallemi si komuna më kampione për transparencë, andaj unë e vlerësoj që puna jonë e përbashkët ka arritë deri në këto suksese që i kemi pasë deri sivjet.

Arsim Jashari, tha se me thanë po i de motivoni qytetarët në shumës, është e rëndë, sinqerisht është e rëndë, se jemi prej grupit të Asamblesë së PDK-së ma së shumti u bëjmë thirrje qytetarëve edhe ma së shumti marrim pjesë.

Anila Reqica-LLugiqi, tha se unë thjesht e thashë është thënë disa herë nga këto karrige të Kuvendit që pavarësisht pjesëmarrjes së qytetarëve nuk janë marrë kërkesat e tyre parasysh nga ekzekutive, për këtë e thashë që nuk ka nevojë për de motivim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, 9 kundër dhe 1 abstenim aprovoi propozimin

V

Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 15Nr.016/01-67386 i datës 22.12.2023 për miratimin e planit komunal për integritet 2023-2026

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-LLugiqi i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propzimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, 4 abstenim aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim Për miratimin e raportit mbi vlerësimin e dëmeve në bujqësi, ekonomi familjare dhe infrastrukturë publike të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në periudhën janar-nëntor 2023

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se dhe më lejoni që në emër të gjithë anëtarëve të kuvendit te ia uroj profen pensionin duke i uruar shëndet dhe suksese ku për shumë vite edhe ka qenë i bashkëpunëtor i jashtëzakonshëm pastaj kryesuesi Daut Azemi, ia dha fjalën Haqif Rrustemi, Kryesues i komisionit i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se e falënderoj edhe unë profen për kontributin i uroj pensionim shëndet dhe te gjitha te mirat. Kam një pyetje a ka kohë ende me aplikuar për demet e shkaktuar nga vërshimet pasi qe mua me është dëmtuar shtëpia dhe tani jam i detyruar te banoj me qira, por nuk kam aplikuar për kompensim edhe pse jam dëmtuar shumë, me ka hy uji ne shtëpi.

Haqif Rrustemi, tha se me vendim te kryetarit janë themeluar 3 komisione te ndryshme njëra nga këto ka qen për vlerësimet e dëmeve nga vërshimet dhe afati ka qen me aplikuar 7 ditë.

Dimant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se në të kaluarën Ministria i ka kompensua dëmet pa pasë nevojë për një miratim të raportit prej Asamblesë Komunale, por neve na ka njoftua shumë vonë. Në mes të nëntorit na ka kërkuar që aprovohet ky raport i Komisionit të miratohet në Asamblenë Komunale, pastaj t'i dërgohet Agjencisë së Emergjencave që pastaj ata t'i kryejnë kompensimet për bujqit. Deri në këtë periudhë, ne kemi si komision këto vlerësimet e komisionit, bashkë me kryetarin e komunës dhe drejtorin për bujqësi kemi mbuluar rreth dyzet bujq që e kapim vlerën diku rreth 40 mijë euro, , vetëm prej sektorit të bujqësisë domethënë dëmat që janë shkaktua në bujqësi.

Arsim Jashari, unë thashë, mu më ka ndodhë një janar dhe nuk kam bere kërkesë, unë muj me bë një kërkesë individuale mu më ndihmua komuna se e kanë të

drejtën qytetarëve. Por unë pyeta nëse ka afat, se tash po vërej mua më ka ndodhë problemin. Mirëpo si duket me nuk paska afat.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për aprovoi propozimin.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:45.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi